

ESI newsletter 2/2015  
10 mars 2015

## VIZAT DHE AZILI

### Situatë Alarmuese në Turqi – Trajtim i padrejtë i Kosovës – Problemi i Gjermanisë



Prishtina (Kosovë) – Berlin (Gjermani)

Të nderuar miq,

Procesi i liberalizimit të vizave me Bashkimin Evropian (BE), që nisi në vitin 2012 për Kosovën dhe vitin 2013 për Turqinë, sot është në krizë.

Në vitin 2014 u numëruan më shumë se 110,000 aplikacione për azil në BE nga shtatë shtetet që synojnë anëtarësimin në BE (A7) – Shqipëria, Bosnja e Hercegovina, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, Serbia dhe Turqia.

Në fillim të vitit 2015, [mediat ndërkombëtare raportuan për dhjetra mijëra qytetar të Kosovës që kalonin kufirin e BE-së ilegalisht](#). Ndërkohë që qeveria turke, e preokupuar me numrin e madh të [refugjatëve sirianë](#) – më shumë se 1.6 milion - nuk është duke i kushtuar vëmendje procesit të liberalizimit të vizave me BE-në.



Përballja me krizën: Dimitris Avramopoulos, komisioner për çështje të brendshme, viziton Kosovën këtë javë

Javëve të fundit, analistët e ESI-t kanë diskutuar të ardhmën e liberalizimit të vizave me zyrtarë të lartë të BE-së, ministra dhe ekspertë nga Evropa Juglindore; ne gjithashtu prezantuar propozimet tona në **Ankara** dhe **Stamboll**, Sarajevë, **Prishtinë**, Berlin dhe Bruksel.

Ne identifikuar tre hapa që duhet të ndërmerren menjëherë.

I pari është që niveli më i lartë qeveritar në Ankara të fokusohet në liberalizimin e vizave; i dyti është që Komisioni Evropian (KE) të ndryshojë mënyrën se si e monitoron procesin e liberalizimit të vizave në Kosovë; dhe i treti ka të bëjë me reformat në mënyrën e shqyrtimit të aplikacioneve për azil në shtetet anëtare të BE-së, sidomos në Gjermani.

Nëse këta hapa do të ndërmerren tani, do të realizohet vizioni për një Evropë Juglindore më të sigurtë, qytetarët e së cilës do të mund të udhëtojnë pa viza në zonën Schengen duke filluar nga viti 2017.

### **Situatë Alarmuese në Turqi**

Procesi i liberalizimit të vizave mes Turqisë dhe BE-së filloi me 16 dhjetor 2013. Për t'u kualifikuar për liberalizim vizash Turqia duhet të përmirësojë menaxhimin e kufijve, të vendosë një sistem azili që përmbushë standardet ndërkombëtare, të respektojë të drejtat e njeriut dhe të luftojë migrimin ilegal. Të gjitha këto kritere janë përshkruar në udhërrëfyes in për liberalizim të vizave.

Kur procesi filloi në vitin 2013, kryeministri i atëhershëm Erdogan tha që deri në mes të 2017-ës qytetarët turq do të udhëtojnë pa viza në BE. Por duke parë se si është duke u zhvilluar situata në Turqi, kjo mund të mbetet vetëm një ëndërr.

Më 20 tetor 2014, KE nxorri raportin e parë të progresit. Në bazë të këtij raporti, ESI krijoi një tabelë notash vlerësuese për progresin e arritur në përmbushjen e kritereve të udhërrëfyesit.

Raporti renditë 72 kritere prej **udhërrëfyesit** dhe vlerësimin e KE-së për përmbushjen e tyre. Për 27 kritere, KE vlerësoi se Turqia është "larg përmbushjes" apo "nuk ka zhvillim pozitiv në atë drejtim."

**Marrëveshja për riatdhesim me BE**-në ka qenë parakusht për fillimin e procesit të liberalizimit të vizave me Turqinë. Kjo marrëveshje hyri në fuqi me 1 tetor 2014.

Pas një periudhe tranzicioni 3 vjeçar, pra prej 1 tetorit 2017 – Turqia do të detyrohet të pranoj të gjithë ata persona për të cilët ka prova se kanë kaluar ilegalisht në BE përmes Turqisë, edhe nëse nuk janë shtetas turq. Nëse Turqia fillon ta implementojë këtë tek në vitin 2017, do të kalojë edhe shumë kohë për ta bërë liberalizimin e vizave realitet.

Por situata është më keq se kaq. Marrëveshjet individuale për riatdhesim me shtetet anëtare nuk janë duke u përfillur. **Marrëveshja me Greqinë** është në fuqi prej vitit 2002. Në vitin 2014 Greqia bëri kërkesë për riatdhesimin e 9,700 migruesëve ilegal. Turqia pranoi veç 470 prej kërkesave dhe vetëm 6 prej tyre u riatdhesuan në Turqi.

Mospërfillja e marrëveshjes nuk ka kuptim, sidomos duke marrë parasysh që Turqia është duke i akomoduar së paku 1.6 milion sirianë dhe pranimi i disa mijëra personave nga Greqia nuk do të vërehej shumë.

#### Marrëveshja për riatdhesim mes Turqisë dhe Greqisë

	kërkesa	të pranuar	të riatdhesuar
2012:	20,464	823	113
2013:	3,741	370	35
2014:	9,619	470	6

Mbrojtja e të dhënave personale është gjithashtu problem në Turqi. Kriter kyq është një ligj për mbrojtjen e të dhënave personale sipas standardeve evropiane. Qëllimi i një ligji të tillë është të mbrohen të dhënat personale kur njerëzit blejnë diçka përmes internetit, hapin llogari bankare apo kanë punë me polici dhe gjykata. Pa këtë ligj këto të dhëna mund të bien në duar të kujtudo.

Draft ligji që Turqia prezantoi në parlament nuk i **plotëson standardet e BE-së**. KE i ka treguar Turqisë por pa sukses. Kjo e nënvlerëson bashkëpunimin policor me BE-në. Europol-it (agjencioni policor i BE-së) dhe Eurojust-it (rrjeti i autoriteteve gjyqësore në BE) ligjërisht iu ndalohet shkëmbimi i të dhënave personale me shtete që nuk kanë ligje për mbrojtjen e të dhënave personale sipas standardeve të BE-së. Kështu që Turqia nuk do të mund të vendosë mardhëniet e nevojshme me këto agjencione.

#### **Turqia, vizat dhe të drejtat e njeriut**

Një kriter kyq për Turqinë ka të bëjë me të drejtat e njeriut:

"Rishikojeni – sipas Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GjEDNJ)..., ligjit të BE-së dhe praktikave të shteteve anëtare – kornizën ligjore sa i përket krimit të organizuar dhe terrorizmit, si dhe interpretimin e saj nga gjykatat dhe forcat e sigurisë...në mënyrë që **të sigurohen në praktikë e drejta për liri dhe siguri, e**

## **drejta për gjykim të drejtë, liri të shprehjes, e drejta e mbledhjes dhe asociacionit.”**

Në raportin e tetorit 2014 KE vlerësoi se “nuk ka zhvillime pozitive” në Turqi në adresimin e këtij kriteri.

Në vitin 2014, Turqia ishte, pas Ruisë, shteti me numrin më të madh të gjykimeve nga GjEDNj (94 gjykime). Turqia ka mohuar të drejtën për liri dhe siguri 45 herë, për gjykim të drejtë 31 herë dhe liri të shprehjes 24 herë.

Të drejtat e njeriut janë të rëndësishme për liberalizimin e vizave. Shtetet e BE-së nuk dëshirojnë të merren me valë të kërkesave për azil që mund të rezultojnë të suksesshme, pasi të liberalizohen vizat. Në vitin 2014, janë shqyrtuar 4,600 aplikacione individuale për azil në BE nga qytetarët turq, dhe 760 prej tyre kanë marrë përgjigje pozitive për mbrojtje ndërkombëtare nga persekutimi. Kjo do të thotë që 17 përqind e kërkesave për azil kanë marrë përgjigje pozitive.

Ky është numri më i lartë i përgjigjeve pozitive prej që Eurostat-i ka filluar t’i mbledhë këto të dhëna. Me këtë numër Turqia del më keq se Azerbajxhani (16 përqind), Ukraina (16 përqind) and i afrohet Pakistanit (19 përqind) dhe Egjiptit (21 përqind). Nëse Turqia dëshiron ta arrijë liberalizimin e vizave deri në vitin 2017, duhet ta adresoj këtë çështje alarmuese menjëherë.

### **Trajtim i padrejtë i Kosovës**



Prishtina

Kosova pranoi udhërrefyesin e shumëpritur për liberalizimin e vizave më 14 qershor të vitit 2012. Udhërrefyesi renditë të gjitha reformat – ngjashëm me atë të Turqisë - që Kosova duhet të përmbushë që të kualifikohet për liberalizim vizash në zonën Schengen.

Në korrik të vitit 2014, KE nxorri një raport për progresin që ka bërë Kosova. Ky raport është i çuditshëm dhe ndryshe nga raportet e progresit që kanë pranuar fqinjët ballkanik në vitet 2008-2010. Raporti është poashtu ndryshe edhe nga raporti për Turqinë.

Në rastin e Ballkanit Perëndimor, KE ka përshkruar progresin për çdo pikë të përfshirë në udhërrëfyes, me formulime precize. Kjo na ka mundësuar formulimin e tabelave me nota vlerësimi për përmbushjen e secilit kriter. Komisioni ka përdorur gjashtë shprehje të ndryshme të vlerësimit:

“ka përmbushur kriterin” dhe “kryesisht ka përmbushur kriterin” (nota 1 sipas ESI)

“ka përmbushur kriterin në masë të madhe” dhe “ka përmbushur pjesën kryesore të kriterit” (nota 2)

“në drejtim të duhur, por...” dhe “ende nuk ka përmbushur kriterin” (nota 3)

Kjo, për shembull, është tabela me nota për Shqipërinë (*vetëm në gjuhën angleze*, 26 prill 2010): [ESI Scorecard for Albania and Bosnia: Meeting the roadmap conditions](#)

Komisioni ka përdorur formulimet në vijim për ta përshkruar progresin në çdo kriter, në [raportin e tetorit të vitit 2014 për Turqinë](#):

- “Kërkesa është përmbushur” (**nota 1** sipas ESI)
- “Kryesisht është përmbushur (d.m.th. vetëm pak punë nevojitet që të përmbushet kriteri plotësisht)” (**nota 2**)
- “Pjesërisht është përmbushur, por me potencial për progres të mëtutjeshëm (d.m.th. ka nevojë për shumë punë, mirëpo rezultatet e arritura dhe puna e kryer nga autoritetet turke janë të dukshme dhe zhvillimet e deritashme janë inkurajuese)” (**nota 3**)
- “Përmbushur vetëm pjesërisht (d.m.th. ka nevojë për shumë punë për të përmbushur kriterin dhe nuk është pare ndonjë zhvillim i qartë pozitiv në këtë drejtim)” (**nota 4**)
- “Kërkesa nuk është përmbushur (d.m.th. Turqia është larg nga përmbushja e këtij kriteri)” (**nota 5**)

Kjo ka mundësuar formulimin e një tabele tjetër me nota vlerësimi (*vetëm në gjuhën angleze*, dhjetor 2014): [Turkey's visa liberalisation roadmap: the scorecard](#).

Deri tani Komisioni ka hartuar shtatë udhërrëfyes (pesë për pesë vendet e para të Ballkanit Perëndimor, një për Kosovën, një për Turqinë) dhe disa raporte të vlerësimit, duke përfshirë dy për Kosovën. Këta dy të fundit, janë shkruar ndryshe nga të gjitha raportet tjera.

Mungesa e precizitetit do të thotë që progresi nuk është matur në mënyrë të drejtë. Raporti për Kosovën nuk përmban shqyrtim të të gjitha kriterëve. Nuk ka përshkrim të saktë të progresit. Gjuha është e paqartë. Kjo e vështirëson adresimin e drejtë të kriterëve nga qeveria si dhe i pamundëson shoqërisë civile të bëjnë presion tek liderët.

Përvoja nga vitet e kaluara është e qartë: një proces i rreptë por i qartë i monitorimit dhe vlerësimit të progresit është kyq për liberalizimin e vizave.

## Azili dhe problemi i Gjermanisë



Thomas de Maiziere

*“Ministri i Brendshëm Skender Hyseni ka kërkuar liberalizim të vizave për Kosovën. De Maiziere nuk është treguar i gatshëm, duke vënë në dukje faktin që numri i azilkërkesëve serb është rritur dukshëm, pas liberalizimit të vizave për Serbinë” (Frankfurter Allgemeine Zeitung, 5 mars 2015)*

Shtrohet pyetja se si mund të hiqen vizat për Kosovën nëse ka rrezik që dhjetra, nëse jo qindra, mijëra njerëz të aplikojnë për azil në BE?

Vitin e kaluar, numri i azilkërkesëve Kosovarë ishte 36,000 – shumica e të cilëve kishin kaluar kufirin ilegalisht pasi që ju duhen viza për të udhëtuar në BE. Sa do të aplikonin po të mos ju nevojiteshin viza për udhëtim?

Në fakt, ky problem ekziston sot edhe për fqinjët e Kosovës: Shqipërinë, Bosnje dhe Hercegovinë, Maqedoninë, Malin e Zi dhe Serbinë, të cilët mund të udhëtojnë pa viza që nga vitet 2009/2010. Kërkesat për azil nga këto vende janë rritur nga 10,000 para liberalizimit të vizave në 70,000 vitin e kaluar.

Sidoqoftë, vetëm 3.6 përqind janë kualifikuar në vitin 2014 për mbrojtje ndërkombëtare për shkak të frikës nga persekutimi apo rreziku për lëndime serioze. Ky numër është 94 përqind për sirianët, 52 përqind për afganët dhe 22 përqind për rusët.

Çfarë mund të bëhet që të zvogëlohen këta numra? Përgjigja është e qartë dhe Gjermania është kyqe. Në vitin 2014, afër 80 përqind të azilkërkesëve nga Ballkani kanë shkuar në Gjermani. Nuk është çudi: sistemi i azilit në Gjermani është zemërgjërë dhe shqyrtimi i kërkesave për azil merr shumë kohë. Në vitin 2014, shqyrtimi i kërkesave ka zgjatur nga 4 deri në 5 muaj për azilkërkesit nga Ballkani perëndimor. Nëse ata kanë bërë ankesë kundër përgjigjeve negative për azil, procedura e azilit ka zgjatur deri në 8 muaj.

Shkelja e të drejtave të njeriut nuk është problem në Ballkanin perëndimor. Azilkërkuesit nga Ballkani perëndimor janë të varfër, kryesisht të papunë dhe pa perspektivë për punë. Shumë nga ata janë nga komuniteti Romë të cilët jetojnë në kushte shumë të vështira. Ata e mirëpresin mundësinë për të kaluar disa muaj në BE si azilkërkues. Kjo mundësi u ofron atyre strehim dhe ushqim, kujdes mjekësor dhe disa përfitime monetare. Disa gjejnë punë në tregun e zi dhe ruajnë para për t'i çuar në shtëpi.

Zgjidhja është e qartë. Në Gjermani në fund të vitit 2012, kohëzgjatja e shqyrtimit të kërkesave për azil zbriti në 9 ditë pasi që zyrtarët gjerman i prioritzuan kërkesat nga Ballkani. Kjo rezultoi në zbritje drastike të numrave të azilkërkuesëve brenda disa javëve. Por ky numër pati rritje përsëri kur kohëzgjatja e shqyrtimit të kërkesave për azil nga Ballkani u rrit prapë.

Vitin e kaluar Gjermania shpalli Serbinë, Maqedoninë dhe Bosnje e Hercegovinën vende të sigurta të origjinës. Sidoqoftë, ky vendim ndikon vetëm afatet për ankesë dhe kthim pas marrjes së një vendimi negativ. Përderisa azilkërkuesit presin me muaj për intervistë dhe vendim, ata do të vazhdojnë të vijnë. Autoritetet gjermane duhet të gjejnë një mënyrë për të shqyrtuar këto kërkesa brenda disa ditëve.

### **Eksperienca e Zvicrrës**

Zvicra - shtet anëtar në zonën Schengen – vendosi procedura të përshpejtuara për shqyrtim aplikacionesh për azil, qysh në vitin 2012. Fillimisht, këto procedura merrnin 4 muaj kohë. Në atë kohë në Zvicërr kishte shumë azilkërkues nga Ballkani perëndimor.

Në gusht të vitit 2012, Ministria Federale e Zvicrrës për Migrim vendosi “masa të veçanta” për vendet e sigurta evropiane me liberalizim vizash. Tani, azilkërkuesit nga ato vende dërgohen në një qendër pranimi në Bazel. Atje ju bëhet një intervistë fillestare brenda 48 orëve. Brenda 48 orëve të ardhshme ju bëhet një intervistë tjetër e plotë dhe mirret një vendim. Azilkërkuesit që marrin përgjigje negative duhet të largohen brenda 5 ditëve. Në rast të ankesës, Gjykata Administrative Federale merr vendim brenda 2 deri 4 javëve.

Menjëherë pas hyrjes në fuqi të këtyre masave, numrat e azilkërkuerve u zvogëluan dukshëm.

#### **Kërkesat për azil në Zvicërr pas procedurave të reja**


	<b>Gush. 2012</b>	<b>Sht. 2012</b>	<b>Tet. 2012</b>	<b>Nën. 2012</b>	<b>Dhj. 2012</b>
<b>Serbia</b>	410	200	60	35	30
<b>Maqedonia</b>	260	45	20	10	10
<b>Bosnja</b>	95	80	20	35	15
<b>Shqipëria</b>	15	5	5	10	10
<b>Mali i Zi</b>	0	5	0	5	0
<b>Total BP5</b>	<b>780</b>	<b>335</b>	<b>105</b>	<b>95</b>	<b>65</b>

Numrat kanë vazhduar të zvogëlohen. Në vitin 2013, vetëm 770 qytetarë nga pesë vendet e Ballkanit aplikuan për azil në Zvicërr. Në vitin 2014 ky numër ishte 620.

Viti 2017 mund të jetë viti kur më shumë njerëz do të udhëtojnë pa viza në BE, kur do të ketë më pak azilkërkues, bashkëpunim më të mirë policor dhe respektim të të drejtave të njeriut. Por që kjo të arrihet duhet që udhëheqësit në Turqi, Kosovë dhe BE të marrin vendime të duhura sot.

Për më shumë vizitoni [www.whitelistproject.eu](http://www.whitelistproject.eu).

Sinqerisht,



Gerald Knaus



### Fakte interesante – tabela me shifra për viza dhe azil

(Të dhënat nga Eurostat, të nxjerra më 9 mars 2015. Në disa raste mungojnë të dhënat nga Austria)

#### Aprovimi i azilit në instancën e parë - BE 2014

Vendimet	Refugjat – Konventa e Gjenevës	Mbrojtje shtesë	Aprovimi total (Refugjat + m. shte.)	
Siria	69,810	35,760	29,575	94%
Eritrea	15,885	9,675	4,275	88%
Iraku	10,585	4,980	1,960	66%
Irani	8,685	4,730	230	57%
Somalia	9,415	2,175	3,180	57%
Afganistani	17,845	4,970	4,235	52%
Libia	1,335	405	130	40%
Belorusia	470	100	30	28%
Rusia	12,355	2,275	405	22%
Kina	5,110	1,060	60	22%
Kazakistani	570	100	25	22%
Egjipti	2,895	510	85	21%
Pakistani	15,810	1,980	1,065	19%
<b>Turqia</b>	<b>4,590</b>	<b>585</b>	<b>175</b>	<b>17%</b>
Azerbajxhani	2,225	340	10	16%
Ukraina	2,985	105	365	16%
Libani	885	85	35	14%
<b>Moldavia</b>	<b>170</b>	<b>10</b>	<b>10</b>	<b>12%</b>
Maroku	1,835	120	35	8.4%
Armenia	3,900	200	95	7.6%
Bangladeshi	7,370	410	80	6.6%
Algjeria	2,995	110	85	6.5%
<b>Shqipëria</b>	<b>13,390</b>	<b>215</b>	<b>560</b>	<b>5.8%</b>
<b>Kosova</b>	<b>13,220</b>	<b>440</b>	<b>290</b>	<b>5.5%</b>
Tunizia	1,450	40	35	5.2%
Gjeorgjia	6,145	180	70	4.1%
<b>Bosnja</b>	<b>7,210</b>	<b>155</b>	<b>55</b>	<b>2.9%</b>
India	1,695	25	20	2.7%
<b>Mali i Zi</b>	<b>1,355</b>	<b>5</b>	<b>20</b>	<b>1.8%</b>
<b>Serbia</b>	<b>22,085</b>	<b>260</b>	<b>55</b>	<b>1.4%</b>
<b>Maqedonia</b>	<b>8,195</b>	<b>30</b>	<b>15</b>	<b>0.5%</b>

#### Kërkesat për azil sipas nacionaliteteve – BE 2014

Shteti	Numri i kërkesave
1. Siria	115,060
2. Eritrea	36,880
3. Afganistani	36,230
<b>4. Kosova</b>	<b>35,970</b>

<b>5. Serbia</b>	<b>30,450</b>
6. Pakistani	21,525
7. Iraku	20,225
8. Nigeria	19,280
9. Rusia	17,685
<b>10. Shqipëria</b>	<b>16,740</b>
11. Somalia	15,745
12. Ukraina	13,585
13. Mali	12,885
14. Bangladeshi	11,530
15. Gambia	11,415
<b>16. Bosnja</b>	<b>10,475</b>
<b>17. Maqedonia</b>	<b>10,170</b>
18. Irani	10,145
19. Gjeorgjia	8,140
20. R.D. Kongo	7,020
21. Senegali	6,405
22. Guinea	6,220
23. Algjeria	6,140
24. Sudani	6,130
25. Armenia	5,340
26. Shri Lanka	5,295
<b>27. Turqia</b>	<b>4,960</b>
28. Kina	4,955
29. Gana	4,090
30. Maroku	3,960
<b>TOTAL</b>	<b>598,755</b>

#### Kërkesat për azil nga Ballkani perëndimor në BE

	2009	2011	2012	2013	2014(mungon Austria)
	(viza)	(pa viza)			
<b>Serbia</b>	5,460	14,105	19,055	22,375	<b>30,450</b>
<b>Shqipëria</b>	2,065	3,080	7,500	11,075	<b>16,740</b>
<b>Bosnja</b>	1,330	2,655	5,835	7,075	<b>10,475</b>
<b>Maqedonia</b>	930	5,555	9,625	11,065	<b>10,170</b>
<b>Mali i Zi</b>	270	635	1,260	945	<b>1,825</b>
<b>Total BP5</b>	<b>10,055</b>	<b>26,030</b>	<b>43,275</b>	<b>52,535</b>	<b>69,660</b>

#### Gjithçka varet nga Gjermania

#### Kërkesat për azil nga Ballkani perëndimor në Gjermani

2009	2011	2012	2013	2014
(viza)	(pa viza)			

<b>BP5 kërkesa në BE</b>	10,055	26,030	43,275	52,535	69,660
<b>BP5 kërkesa në Gjermani</b>	<b>1,450</b>	<b>9,360</b>	<b>22,715</b>	<b>33,935</b>	<b>53,905</b>
<b>Pjesa gjermane</b>	14%	36%	52%	65%	77%

*Burimi: Antwort der Bundesregierung auf eine Kleine Anfrage der Linksfraktion, 28 Jan. 2014*

### Aprovimi i azilit në Gjermani 2014

	Refugjat	Shtesë	Humanitar	TOTAL
<b>Serbia</b>	1 person (0%)	17 persona (0.1%)	25 persona (0.1%)	0.2%
<b>Maqedonia</b>	2 persona (0%)	5 persona (0.1%)	7 persona (2%)	0.3%
<b>Shqipëria</b>	2 persona (0.3%)	11 persona (1.6%)	-	2.6%
<b>Bosnja</b>	-	-	6 persona (0.2%)	0.3%
<b>Kosova</b>	-	-	5 persona (0.5%)	0.5%
<b>Total në Gjermani</b>	13,053 (30.3%)	456 (1.1%)	577 (1.3%)	

*Burimi: [Antwort der Bundesregierung auf eine Kleine Anfrage der Linksfraktion](#), 28 Jan. 2014*

### Kohëzgjatja e procedurave në Gjermani për shqyrtim kërkesash për azil

	Vendimi 2014	Vendimi + Apeli jan-qer 2014
Shqipëria	3.6 muaj	5 muaj
Bosnja	3.9 muaj	5.5 muaj
Serbia	4 muaj	6.7 muaj
Kosova	4.7 muaj	9.5 muaj
Maqedonia	5.3 muaj	7.7 muaj
Total në Gjermani	7.1 muaj	11.1 muaj

*Burimi: [Antwort der Bundesregierung auf eine Kleine Anfrage der Linksfraktion](#), 28 Jan. 2014*

### Terminologjia për mbrojtje ndërkombëtare në BE

**Statusi i Refugjatit (persekutim)** është forma më e lartë e mbrojtjes ndërkombëtare. Ligjet e azilit në BE janë të bazuara në konventën e KB-së të Gjenevës 1951, që do të thotë se shtetet anëtare të BE-së u ofrojnë status refugjati personave nga vendet e treta që "[kanë frikë të bazuar në fakte nga persekutimi në baza racore, fetare, kombëtare, politike apo anëtarësie në një grup të caktuar social](#)" në shtetin prej nga vijnë.

**Mbrojtja shtesë (rreziku nga dëmi serioz)** ju ipet njerëzve që janë në "rrezik nga dëmi serioz" në vendin prej nga vijnë, por që nuk përkojnë me definicionin e KB-së për refugjat. Për definicion më të detajuar shihni: [relevant EU Directive](#).

**Mbrojtje humanitare:** Disa azilkërkuesëve ju lejohet të rrijnë në një vend të BE-së "[për arsye humanitare](#)". Shtetet anëtare të BE-së vendosin individualisht për këtë. Më së shpeshti kjo mbrojtje u ofrohet njerëzve me probleme shëndetësore që nuk mund të shërohen në shtëpi.

**Në instancën e parë,** kërkesat për azil shqyrtohen prej adimistratave. Ato që refuzohen kanë të drejtë apeli në gjyq dhe kjo është instance tjetër.